



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:215443  
Datë: 31.07.2024  
Numri i dokumentit: 06002372

**PA1.nr. 1273/2023**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët, Zyhdi Haziri kryetar i kolegjit, Mehmet Ndrecaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e praktikantes- procesmbajtëse Fitore Zeka, në çështjen penale kundër të akuzuarve M.M nga Prizreni, për shkak të veprave penale: lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën.par. 1.4 dhe veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK –së, L.B dhe B.B për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën.par. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK –së, duke vendosur sipas ankesës së PTH në Prizren, të ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1440/21 të dt. 07.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 23.07.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, ndërsa aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1440/21 dt. 07.09.2023, **VËRTETOHET**

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar, të akuzuarin M.M, e ka shpallur fajtor për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën.par. 1.4 dhe veprës penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par. 5 lidhur me par. 1 të KPRK –së dhe i ia ka shqiptuar dënimin unik me gjobë në shumën prej 1.700 euro, në dënimin e shqiptuar me gjobë i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 26.09.2021 deri më dt. 26.10.2021, ashtu që i akuzuari është i obliguar që të paguaj shumën e dënimit me gjobë prej 1.100 euro dhe atë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Të akuzuarve B.B dhe L.B ia ka shqiptuar

gjithsecilit dënimin me gjobë prej nga 500 euro, të cilën dënim të akuzuarit janë të obliguar që ta paguajnë në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit nuk e paguajnë dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do tu zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro i llogaritet 1 (një) ditë burgim. Obligohet i akuzuari, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore, në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej nga 20 euro, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 euro, dhe për ekspertizën mjekoligjore të akuzuarit M.M dhe L.B shumën prej 20 eurove, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit. Palët e dëmtuara me adresë si në shkresat e lëndës për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil-juridik.

**- Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur:**

Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale; shkeljeve të Ligjit Penal dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke i propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit që ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshojë ashtu që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv, ose me gjobë me të lartë.

Përgjigje në ankesën e PTH në Prizren, ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit m.m av. S.h nga Prizreni, duke propozuar që ankesa e PTH në Prizren të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokurori i Prokurorisë së Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1307/2023, të datës: 11.10.2023, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa PTH në Prizren, e ushtruar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënim me burgim efektiv, ose me gjobë më të lartë.

Gjykata e Apelit e Kosovës i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioi aktgjykimin e kundërshtuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP, dhe pas vlerësimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se:

**- ankesa nuk është e bazuar.**

PTH në Prizren në ankesë ka theksuar se aktgjykimi është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 nën. Par. 2.7 lidhur me nenin 369 par. 7, me arsyetim se pjesa ndëshkuese e aktgjykimit është në kundërshtim me vetveten dhe me arsyer e paraqitura në arsyetim, dispozitivi është i paqartë i pa kuptueshëm me arsyetimin lidhur me faktet vendimtare, ku në dispozitiv saktësisht përshkruan veprimet e të akuzuarit për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar në këtë drejtim, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore nga neni 369 i KPPRK-së, dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë përshkruar qartë të gjitha veprimet inkriminuese të të akuzuarit, në të cilat veprime manifestohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari. Po ashtu dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar nuk është në kundërshtim

me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.

As gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase me ankesë nuk është atakuar, pasi që të akuzuarit i kanë pranuar veprat penale të kryera.

Aktgjykimi me ankesën e PTH në Prizren është goditur edhe për shkak të shkeljeve të ligjit Penal në dobi të akuzuarit, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare për shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as me shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, në radhë të parë për faktin se nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari dhe aprovimi i kësaj deklarate nga Gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, dhe me këtë rezulton se është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë manifestuar elementet qenësore të kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar i akuzuari, si dhe për faktin se kjo veprë për të cilën është gjykuar i akuzuari është veprat penale, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe ndjekjen penale për këto vepra penale, dhe as zbatim të gabuar të Kodit Penal.

Prokuroria Themelore në Prizren, aktgjykimin e ankimuar e ka atakuar për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke theksuar tutje se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqiptimit të dënimit, ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese dhe se nuk ka gjetur dhe përmendur asnjë rrethanë rënduese, si shkallën e lartë të dashjes, motivet për kryerjen e veprave penale, peshën e veprave penale, faktin se veprat janë kryer brenda marrëdhënieve familjare-ndaj bashkëshortes së tij, e po të vlerësoheshin këto rrethana në mënyrë të duhur, sigurisht se sanksioni penal do të ishte më i lartë.

Duke vlerësuar çështjen sa i përket vendimit për dënimin, Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme të PTH në Prizren që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me burgim efektiv ose me gjobë më të lartë nuk janë të bazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar dhe konstatuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, ka vlerësuar pranimin e fajësisë, pendimin për kryerjen e veprave penale, sjelljen në Gjykatore, ndërsa si rrethana rënduese ka vlerësuar mënyrën e kryerjes së veprave penale, shkallën e lartë të dashjes, e duke u bazuar në këto rrethana i ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me bindjen se dënimi është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, e me të cilin dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të nenit 38 të KPPRK-së.

Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se kolegji penal i kësaj Gjykate, vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**Departamenti i Përgjithshëm**

**PA1.nr.1273/23, me datë 23.07.2024**

**Praktikantja- procesmbajtësja,**

Fitore Zeka

**Kryetar i kolegjit,**

Zyhdi Haziri

**Anëtarët e kolegjit:**

Mehmet Ndrecaj

Abdullah Ahmeti